V E N D I M
Nr. 175, datë 6.3.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 563, DATË 9.10.1995 "PËR APLIKIMIN E PUNËVE PUBLIKE", NDRYSHUAR ME VENDIMET NR. 179, DATË 18.3.1996, DHE NR. 857, DATË 16.12.1996

Me propozimin e Ministrisë së Punëve, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 563, datë 9.10.1995 "Për aplikimin e punëve publike" ndryshuar me vendimet nr. 179, datë 16.3.1996, dhe nr. 857, datë 16.12.1996, në pikat 1 dhe 2 fjalët "Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale" zëvendësohen me fjalët "Shërbimi Kombëtar i Punësimit".

2. Pika 4 ndryshohet si vijon:

"Financimi i projektit përballohet nga:

a) fondet e Buxhetit të Shtetit të caktuara për punët publike;

b) burimet e brendshme të pushtetit lokal;

c) fondet shtetërore për investime;

ç) financime nga organizatat joqeveritare të vendit ose të huaja;

d) financime nga organizma qeveritarë ose joqeveritarë, të cilat, në përputhje me marrëveshjet shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe, administrojnë kredi a ndihma për këtë qëllim;

dh) financime të kombinuara, të përcaktuara në pikat "a","b", "c", "ç","d"".

3. Në pikën 5 bëhen këto ndryshime:

Shkronja "a" ndryshohet si vijon:

"Punimet publike të thjeshta të natyrës së pastrimeve ose sistemimeve që u jepen për zbatim pa tender njësive ekonomike në vartësi të bashkisë a komunës përkatëse, me kusht që të përfshijnë në fuqinë punëtore individë të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, individë që përfitojnë pagesë papunësie, si dhe persona punëkërkues të papunë. Përcaktimi i njësisë bëhet nga zyra kompetente e punësimit, mbi bazën e rekomandimit nga bashkia ose komuna".

- Shkronja "d" ndryshohet si vijon:

"Për punimet publike që organizohen në bashkëpunim me organizmat qeveritarë ose joqeveritarë, fondet shtetërore financojnë pagat në masën e pagës minimale".

4. Pika 6 ndryshohet si vijon:

"Fondet e punëve publike tërhiqen në degën e thesarit, sipas situacioneve të paraqitura për këtë qëllim, të hartuara nga drejtuesi i punimeve dhe të miratuara nga kryetari i komunës a bashkisë dhe zyra kompetente e punësimit. Fondet e papërdorura nuk lejohen të kalojnë në destinacion tjetër; ato rishpërndahen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit".

5. Pika 7 ndryshohet si vijon:

"Fuqia punëtore caktohet nga zyra kompetente e punësimit. Personat nën 18 vjeç e mbi 45 vjeç dhe ata me arsim të lartë nuk vendosen në mënyrë të detyruar, por vetëm nëse deklarohen vetë vullnetarisht".

6. Pika 10 ndryshohet si vijon:

"Shërbimi Kombëtar i Punësimit informon çdo muaj Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas për ecurinë e projekteve të punëve publike."

7. Pika 11 ndryshohet si vijon:

"Shërbimi Kombëtar i Punësimit inspekton dhe kontrollon zbatimin e projekteve të punëve publike".

8. Shtohet pika 14 me këtë përmbajtje:

"Krijohet Komiteti Shtetëror për Punët Publike që kryesohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas dhe përbëhet me përfaqësues nga Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, që caktohen nga drejtuesit e këtyre institucioneve. Komiteti ka për qëllim ndjekjen, bashkërendimin dhe propozimin e politikave të

përgjithshme shtetërore për programet e punëve publike. Për hartimin e procedurave të funksionimit të këtij komiteti ngarkohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano